



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2020:917237

Datë: 13.06.2023

Numri i dokumentit: 04387666

C.nr.463/2019

GJYKATA THEMELORE PRIZREN- DEGA E GJYKATËS SUHAREKË- Departamenti i përgjithshëm- Divizioni civil, me gjyqtar Selajdin Gallapeni në çështjen juridiko-kontestimore të paditëses: E. B., të cilën e përfaqëson përfaqësuesja ligjore L. B., nga fshati R., Komuna e Suharekës, ndërsa sipas autorizimit të njëjtën e përfaqëson, av. S. H. nga Suhareka, kundër të paditurave: Kompania e Sigurimeve "Iliria" me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson A. L. dhe të paditurës së dytë, Byrosë Kosovare të Sigurimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson O. H., me objekt të çështjes kontestimore kompensim dëmit, kjo gjykatë pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me datë 12.06.2023 bie këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditëses E. B., të cilën e përfaqëson përfaqësuesja ligjore L. B., nga fshati R., Komuna e Suharekës, ndërsa sipas autorizimit të njëjtën e përfaqëson, av. S. H. nga Suhareka, ashtu që **detyrohen të paditurat**: e Kompania e Sigurimeve "Iliria" me seli në Prishtinë dhe e paditura e dytë, Byroja Kosovare e Sigurimit, që në mënyrë solidare t'ia kompensojnë palës paditëse në emër të dëmit material dhe atij jo material, shumat si në vijim:

Për dëmin jo material, aprovet pjesërisht shuma prej 9.000€ (nëntëmijë), për këto kategori të dëmit, në shumat si në vijim:

- për dhimbje fizike (trupore), shumën prej4.000 €,
- për frikën e përjetuar, kategoritë e saj, shumën prej..... 2.000€,
- për shëmtim shumën prej1.000€,
- për zvogëlimin e aktivitetit jetësor për shkallën 5%, shumën prej 2.000 €

Për dëmin material, gjithsej shuma e aprovuar në tërësi është 600€(gjashtëqind euro) dhe atë:

- për ndihmën dhe përkujdesjen e personit të huaj, shumën prej300euro;
- për ushqimin e përforcuar shumën prej..... 300 euro;

Ku për të gjitha këto shuma të vendosura si më lartë për dëmin material dhe jo material në lartësinë e përgjithshme prej 9.600.00€ (nëntë mijë e gjashtëqind euro), obligohen të paditurat që t'ia paguaj paditësit në afatin prej 15 ditësh, nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm, të gjitha këto shuma me kamatë ligjore prej 8%, ku afati për llogaritjen e kamatës për dëmin material fillon që nga parashtrimi i padisë me datë 13.01.2016, ndërsa për dëmin jo material, kamata fillon te rrjedh nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit datë 12.06.2023.

- II.** Pjesa tjetër e kërkesëpadisë, respektivisht dallimi mbi shumën e aprovuar si në pikën një të këtij dispozitivi REFUZOHET SI E PABAZUAR.
- III.** Obligohen të paditurat, që t'ia paguajnë në mënyrë solidare edhe shpenzimet e procedurës gjyqësore palës paditëse shumën në lartësi prej 3,169.00€ (tremijë e njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë euro), të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

- Pretendimet e palëve ndërgjyqëse, rrjedha e procedurës

Pala paditëse pranë kësaj gjykate me datën 13.01.2016 ka parashtruar padinë për kompensimin e dëmit material dhe jo material kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimit, për aksidentin e pësuar me datën 04.09.2015, në fshatin S., në drejtim të Suharekës, ku deri tek aksidenti vie kur automjeti Golf IV me targa 04-...-EF, duke lëvizur nga fshati S.-Suharekë e godet mbrapa multikultivatorin, ku në këtë rast paditësja pëson lëndime të rënda. Gjykata ka caktuar shqyrtimin gjyqësor, ku pala paditëse pranë kërkesëpadisë ka mbetur gjate gjithë shqyrtimit gjyqësor, ku gjykata gjate shqyrtimit gjyqësor sipas propozimit të palës paditëse i ka nxjerrë provat mjekësore, atë të ortopedisë, me datë 23.02.2017 dhe psikiatrisë, me datë 22.03.2017. Po ashtu në seancën e datës 22.03.2017, gjykata sipas propozimit të palës paditëse bie aktvendimin procedural me të cilin nxirret prova e komunikacionit, ku si ekspert caktohet N. D., ku i njëjti më datë 01.06.2017, bie mendimin e tij lidhur me aksidentin.

Në seancën e datës 05.07.2017, pala paditëse e ndryshon padinë në aspektin subjektiv, duke e zgjeruar padinë edhe ndaj Kompanisë së Sigurimeve Iliria si e paditur e dytë, të cilin propozim aprovet nga ana e gjykatës.

Në seancën e datës 18.10.2017, pala paditëse e ndryshon padinë në aspektin subjektiv, ku e tërheq padinë ndaj BKS-s, (ndryshimi për herë të dytë) për faktin se sipas ekspertizës së komunikacionit të ekspertit N. D. e paditura e dytë përjashtohet nga përgjegjësia. Gjykata me aktgjykimin C.nr.11/2016 të datës 18.10.2017 e aprovon kërkesëpadinë pjesërisht ndaj të paditurës K.S. Illyria, ku e paditura e pakënaqur me këtë aktgjykim parashtron ankesë tek gjykata e shkallës së dytë, ku kjo e fundit me aktvendimin AC.nr.1523/2018 të datës 09.08,2022 e kthen lëndën në rivendosje.

Në procedurën e shqyrtimit gjyqësor, tani në rivendosje, në seancën e datës 18.01.2023, pala paditëse ka ndryshuar serish padinë në aspektin subjektiv (hera e tretë), duke e zgjeruar sërish ndaj BKS-s për faktin se pranë kësaj gjykate është nxjerr aktgjykimi penal P.nr.355/2017 me datë 29.10.2021, ku me këtë rast penal është nxjerr super ekspertiza e komunikacionit, me të cilën provë është konstatuar edhe përgjegjësia e të siguruarit të K.S. Illilyria, si përgjegjësia e drejtuesit të multikultivatorit, i cili nuk ka qenë i siguruar, për të cilën përgjegjës është BKS-ja

E paditura e parë, KS. Illyria, gjate shqyrtimit ka theksuar se, në këtë çështje kontestimore përgjegjësia është solidare për faktin se kjo çështje është vërtetuar mbi bazën e super ekspertizës për lëndën penale, ku ndaj kësaj prove nuk kanë vërejtje.

E paditura e dytë, BKS-ja, e ka kundërshtuar edhe bazën juridike të kërkesëpadisë, duke u thirrur në atë se në rastin konkret kemi të bëjmë me parashkrim.

Në seancën e datës 05.04.2023, ka dhënë sqarime shtesë eksperti ortoped, dr. Rr. Sh., ndërsa në seancën e datës 04.05.2023, kanë dhënë sqarime shtesë koordinatori i grupit të eksperteve të Fakultetit të Injnierisë Mekanike, prof. dr. N. L. dhe prof. Dr. H. P., lidhur me mendimin e tyre të datës 07.05.2021 dhënë në procedurë penale, ku të njëjtit kanë theksuar se ashtu siç është potencuar ne super ekspertizën me shkrim, se ekziston përgjegjësia në të dy automjetet e përfshira në aksident, tek multikultivatori i kanë munguar sinjalizimet e natës, ndërsa tek automjeti tjetër Golf IV, nuk i ka vërejt me kohë pengesën e pandriçuar (multikultivatorin), me çka ka ardhur deri tek aksidenti.

Ne seancën e shqyrtimit kryesor të datës 04.05.2023, në fjalën përfundimtare pala paditëse ka theksuar se, sipas mendimit të grupit të ekspertëve, super ekspertizës përgjegjës për aksidentin janë të dy pjesëmarrësit në komunikacion, ndërsa sipas mendimit të ekspertit ortoped dhe psikiatër është përcaktuar shkalla e lëndimeve dhe e frikës, ku e njëjta sa i përket kërkesëpadisë ka theksuar se mbetet si në precizimin e lartësisë të dorëzuar me shkrim me parashtresën e datës 04.09.2017, në të cilën ka theksuar se, për të gjitha kategoritë e dëmit material dhe jo material pala paditëse duhet të kompensohet shuma e përgjithshme prej 13.300 euro, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% në vit që nga dita e paraqitjes së padisë. Ndërkaq shpenzimet e procedurës gjyqësore i ka kërkuar në shumën prej 3,169 euro.

E paditura e parë K.S. Illyria, në fjalën përfundimtare ka theksuar se, për faktin se në rastin konkret kemi të bëjmë me kompensimin e dëmit e cila ndërlidhet me veprën penale, në rastin konkret i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadia të refuzohet në raport me të paditurën e parë dhe ta aprovon të njëjtën ndaj të paditurës së dytë.

E paditura e dytë, BKS-ja, në fjalën përfundimtare ka theksuar se, mbetet pranë theksimeve si në përgjigjen në padi, si dhe deklarimeve në seancat e mbajtura, duke shtuar se i kundërshtojmë pretendimet e të paditurës së parë pasi që në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me përgjegjësi penale por me përgjegjësi civile. Po ashtu ka theksuar se ndaj të paditurës së dytë kërkesëpadia është parashkuar sipas nenit 357.1 të LMD-s, pasi që paditësja është njoftuar për dëmin e shkaktuar më rastin e pranimit të raportit policor dhe pranimit të ekspertizës në procedurën penale të datës 29.12.2015 të punuar nga inj. E. M.. Po ashtu e ka kundërshtuar edhe për faktin se paditësja me rastin e aksidentit ka qenë e ulur në vendin jo adekuat në multikultivator.

Administrimi i provave

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata në seancën e dt.04.05.2023 ka administruar provat si në vijim:

Janë lexuar provat si në procesverbalin e datës 18.10.2017, në të cilën seancën janë administruar këto prova:

- Aktakuza PTHP Pp.nr.2735/15 e datës 08.05.2017;
- Raporti i policisë 2015-GR-0294 e datës 04.09.2015;
- Raportet mjekësore te referuara si ne mendimin e ekspertit ortoped dr. Rr. Sh.;
- Ekspertiza e ekspertit të komunikacionit E. M. dhënë për Prokurorin Themelore Prizren e datës 29.10.2015,
- Mendimit të ekspertit të komunikacionit N. D. të datës 01.06.2017, *si dhe provat tjera te administruara tani në procedurën e rivendosjes,*
- Aktgjykimin penal të kësaj gjykate P.nr.355/2017 të datës 29.10.2021;

- Super ekspertizën me nr.033 e datës 07.05.2021 të dhënë nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, Prishtinë, për lëndën penale P.nr.355/2017, e punuar nga grupi prof. dr. N. L., H. P. dhe E. Q..

Andaj, gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se, ***kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e bazuar.***

- ***Vërtetimi i gjendjes faktike***

Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ka qenë kontestuese çështja e shkallës së lëndimeve tek pala paditëse, por në mes të palëve ndërgjyqëse ka qenë kontestuese çështja e bazës së kërkesëpadisë, ku e paditura e parë K.S. Illyria (referuar në vijim si e paditura e parë), ka theksuar se përgjegjësia e kompensimit të dëmit i takon të paditurës së dytë pasi që në rastin konkret kemi të bëjmë me lëshimet e drejtuesit të multikultivatorit, për të cilën i njëjti është dënuar në procedurë penale, ndërsa të kundërtën e kësaj e ka pohuar BKS-ja (referuar ne vijim si e paditura e dytë), duke shtuar se ndër të tjera kemi të bëjmë me parashkrim sepse paditësja është njoftuar për dëmin e shkaktuar më rastin e pranimit të raportit policor dhe pranimit të ekspertizës në procedurën penale të datës 29.12.2015 të punuar nga inj. E. M..

Nga prova e nxjerrë në procedurën penale për lëndën P.nr.355/2017 dhe e cila është administruar në këtë çështje civile, si super ekspertiza me nr.033 e datës 07.05.2021 të dhënë nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, Prishtinë, për lëndën penale P.nr.355/2017, e punuar nga grupi prof. dr. N. L., H. P. dhe E. Q., gjykata ka vërtetuar faktin se deri tek aksidenti i datës 04.09.2015, ka ardhur me lëshimet e drejtuesve të të dy automjeteve. Gjykata i ka ftuar ekspertet prof. dr. N. L., H. P. të cilët në seancën e datës 04.05.2023, të njëjtit kanë dhënë sqarime shtesë për palët dhe gjykatën. Pra gjithnjë sipas mendimit të tyre të njëjtit kanë theksuar, se ekziston përgjegjësia në të dy automjetet e përfshira në aksident, tek multikultivatori i kanë munguar sinjalizimet e natës, ndërsa tek automjeti tjetër Golf IV, nuk i ka vërejt me kohë pengesën e pandriçuar (multikultivatorin), me çka ka ardhur deri tek aksidenti, ku gjykata mendimit të grupit të ekspertëve ia fali besimin për faktin se e njëjta është e bazuar në saje të provave si dhe të njëjtit kanë dalë edhe në vendin e ngjarjes.

Po ashtu faktin të dy palët e përfshira në aksident kanë pasur lëshime, një fakt i tillë vërtetohet edhe nga ekspertiza tjetër e nxjerrë në procedurë penale e ekspertit E. M. e datës 29.10.2015, në të cilën eksperti në fjalë thekson se lëshimet e drejtuesit të multikultivatorit qëndrojnë në faktin se të njëjtit i kanë munguar pajisjet sinjalizuese, ndërsa drejtuesi i automjetit golf IV, nuk e ka përshtatur shpejtësinë kushteve dhe rrethanave të komunikacionit. Kësaj prove gjykata ia fal besimin për faktin se e njëjta mbështete edhe në provën tjetër të kësaj natyre siç është super ekspertiza e grupit të eksperteve me nr.033 e datës 07.05.2021.

Ndërsa gjykata nuk ia fali besimin mendimit të ekspertit të komunikacionit N. D. të datës 01.06.2017, për faktin se kjo provë përgjegjësia e bartë vetëm tek drejtuesi i automjetit golf IV, si dhe për faktin se kjo provë bie ndesh edhe me dy ekspertizat tjera të komunikacionit, atë E. M. të datës 29.10.2015, si dhe super ekspertizës me nr.033 e datës 07.05.2021 të dhënë nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike Prishtinë, për lëndën penale P.nr.355/2017, e punuar nga grupi prof. dr. N. L., H. P. dhe E. Q., gjykata ka vërtetuar faktin se deri tek aksidenti i datës 04.09.2025, ka ardhur me lëshimet e drejtuesve të të dy automjeteve. Pra ekspertiza e N. D. e datës 01.06.2017 sipas vlerësimit të gjykatës si e tillë është edhe jo e plotë për faktin se nuk i ka marr për bazë

edhe lëshimet e drejtuesit të automjetit të multikultivatorit, i cili nuk i ka pasur sinjalizuesit gjate natës, dritat apo pjesët tjera ndriçuese.

Nga provat e administruara si, Aktakuza PTHP Pp.nr.2735/15 e datës 08.05.2017, Raporti i policisë 2015-GR-0294 e datës 04.09.2015, si dhe Aktgjykimin penal të kësaj gjykate P.nr.355/2017 të datës 29.10.2021 (i plotfuqishëm që nga data 30.11.2021), gjykata ka vërtetuar faktin se me rastin e aksidentit të datës 04.09.2015, në rrugën R.-Suharekë, në fshatin S., tek gurthyes "E.", këtu është dënuar personi i cili ka qenë drejtues i multikultivatorit dhe i cili ka qenë pa mbulesë siguroese. Pra nga këto prova, konkretisht nga aktgjyrimi penal i plotfuqishëm, shihet se këtu drejtuesi i automjetit në fjalë deri tek aksidenti ka ardhur për faktin se i njëjti automjetin e tij (multikultivatorin) nuk e ka pasur të pajisur me drita sinjalizuese.

Nga prova, ekspertiza mjekësore e ortopedit dr.Rr. Sh., e datës 23.02.2017 dhe mendimet shtesë si në seancën e datës 05.04.2023, gjykata ka vërtetuar faktin se këtu paditësja si pasojë e aksidentit ka pësuar lëndime të rënda trupore ne pjesën e kokës, si ndrydhje të kokës, plagë shkyese dermishëse, gjakderdhje nën cipën e trurit si dhe tronditje të trurit, ku si pasojë e këtyre lëndimeve e njëjta ka kufizim për jetën në shkallën prej 5%. Po ashtu e njëjta ka shëmtim trupor të lehtë për faktin se vraga është në pjesën e kokës e mbuluar me flokë.

Ndërsa në seancën e datës 22.03.2023 eksperti psikiatër dr. N. F. ka theksuar se tek paditësja nga aksidenti nuk und të konstatohet frika primare për faktin se e njëjta pas aksidentit ka pësuar humbje të vetëdijes, ndërsa ka pësuar frikë sekondare të intimitetit të larte, e cila ka zgjatur 24 orë, frikë të intensitetit të mesëm e cila ka zgjatur rreth një muaj dhe frikë të intensitetit të ulët e cila ka zgjatur rreth një vit.

Kurse, për shumën e kompensimit të dëmit material, gjykata vendosi shumën prej 600 euro për ndihmën dhe përkujdesjen e personit të huaj, shumën prej 300euro dhe për ushqimin e përforcuar shumën prej 300 euro, kjo duke u bazuar në saje të mendimit të ekspertit ortoped dr. Rr. Sh., i cili në mendimin e tij të datës 23.02.2017, ka theksuar se ndihma e personit tjetër ka qenë e nevojshme për 30 ditë, çka nënkupton se paditësja brenda këtij afati nuk ka mundur që të përkujdesej për nevojat e saja pa ndihmën e personit tjetër. Po ashtu i njëjti ekspert ka theksuar se paditësja pas aksidentit e ka pasur të domosdoshme që të përdorte ushqim të përforcuar, të përzgjedhur. Andaj për këto dy kategori të dëmit material gjykata vlerëson se shumat e vendosura nga ana e gjykatës janë ekuivalente më shpenzimet, përkatësisht përkujdesjen e personave të tretë ndaj paditëses.

Sa i përket vendosjes si në pikën e parë të dispozitivit për dëmin jo material, kategoritë e saj, gjykata vendosi që ta aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë për shumat prej 9.000€ (nëntë mijë). Pra gjykata vendosi që për dhimbje fizike (trupore), shumën prej 4.000 €, për faktin se paditësja me rastin e aksidentit ka pësuar lëndime të rënda, ku për të gjitha këto kategori të dhimbjeve fizike gjykata i ka vërtetuar nga ana e mendimit të ekspertit ortoped Dr. Rr. Sh., ku gjykata kësaj ekspertize ia ka falur besimin edhe për faktin se palët ndergjyqëse nuk kanë pasur vërejtje ndaj të njëjtës.

Ndërsa sa i përket frikës dhe llojeve të saj, gjykata ka vendosur në shumën prej 4.000€, duke u bazuar sipas mendimit të ekspertit dr. N. F. dhënë në seancën e datës 22.03.2017, ku i njëjti ka theksuar se paditësja me rastin e aksidentit ka pësuar frikë, ku frika primare nuk mund të konstatohet për faktin se pas aksidentit paditësja ka pasur humbje të vetëdijes si dhe ka pësuar amnezion, ndërkaq ka pësuar frikë sekondare të intensitetit të lartë e cila ka zgjatur 24 orë, frikë

të intensitetit të mesëm që ka zgjatur rreth një muaj, si dhe frikë sekondare të intensitetit të ulët që ka zgjatur rreth një vit.

Ndërkaq sa i përket çështjes së shëmtimit tek paditësja gjykata vendosi për shumën 1.000€, për faktin se e njëjta si pasojë e lëndimeve pas aksidentit ka pësuar edhe shëmtim të shkallës së lehtë, ku vraga është e shkaktuar në pjesën e kokës me madhësi prej 5 cm, mirëpo eksperti e ka trajtuar si shëmtim të lehtë për faktin se e njëjta gjendet në pjesën e kokës e cila nuk vërehet për shkak se e njëjta është e mbuluar me flokë.

Sa i përket çështjes së zvogëlimit të aktivitetit jetësor, për shkallën 5%, gjykata ka vendosur në shumën prej 2.000 €, në emër të kompensimit për faktin se gjykata vlerëson së ky aktivitet nuk është i lartë tek paditësja dhe se shuma e caktuar do të jetë një satisfaksion i mjaftueshëm për këtë kategori të dëmit.

- **Baza ligjore**

Me nenin 136 al.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), është paraparë se, citojmë: *“kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë ta kompensoj, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij”*. Ndërsa me nenin 159 parag.1 të LMD-s, është paraparë se, citojmë: *“në rast aksidenti të shkaktuar nga mjete motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi, zbatohen rregullat mbi përgjegjësinë në bazë të fajësisë”*.

Gjykata i vlerësoi pretendimet e të paditurës së parë e cila theksoi se të njëjtës i mungon përgjegjësia për faktin se sipas aktgjykimit penal është dënuar drejtuesi i cili ka qenë pa mbulesë sigurorese e për të cilën përgjegjësia bie mbi të paditurën e dytë BKS-n, gjykata e vlerësoi këtë pretendim mirëpo erdhi në përfundim se një pretendim i tillë është i paqëndrueshëm ngase të kundërtën e saj gjykata e ka vërtetuar në saje të dy provave ekspertizave të komunikacionit, super ekspertiza me nr.033 e datës 07.05.2021 të dhënë nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, Prishtinë dhe ekspertizën e ekspertit tjetër të komunikacionit E. M. të datës 29.10.2015 të dy këto prova të nxjerra në procedurë penale, ku sipas këtyre dy provave përgjegjësia bie mbi të dy drejtuesit atë të golf IV, ku automjeti ka qenë i siguruar tek e paditura e parë dhe të drejtuesi i multikultivatorit pas mbulesë sigurorese, për të cilën përgjegjësia bie mbi BKS-n.

Ndërkaq sipas nenit 14 të Ligjit për procedurën Kontestimore Nr. 03/L-006 theksohet se, citojmë: *“Në procedurën kontestimore gjykata, në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor”*.

Pra nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore vie në shprehje çështja e përgjegjësisë së të paditurës së dytë BKS-s në këtë çështje kontestimore, ku e njëjta tani në procedurën e rivendosjes është thirrur në çështjen e parashkrimit, duke u thirrur sipas nenit 357.1 të LMD-s, ku sipas kësaj dispozite ligjore theksohet se, citojmë: *“Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri (3) vite nga data kur i dëmtuari ka marrë dijeni për dëmin dhe për personin, i cili e ka shkaktuar dëmin”*.

Gjykata e vlerësoi këtë pretendim të të paditurës së dytë (për parashkrim të kërkesëpadisë), mirëpo erdhi në përfundim se e njëjta është e paqëndrueshme për faktin se në rastin konkret gjykata vlerëson se nuk kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës së paditëses ndaj të paditurës së dytë, ngase në rastin konkret kërkesa e paditëses për kompensim ndaj të paditurës së dytë rrjedh nga shkaktimi i dëmit me vepër penale. Për me tepër sipas nenit 358 parag.1 të LMD-s,

theksohet se, citojmë: *“Kur dëmi është shkaktuar me vepër penale dhe për ndjekjen penale është parashikuar një afat më i gjatë parashkrimi, kërkesa për shpërblim të dëmit ndaj personit përgjegjës parashkruhet kur të skadojë koha e caktuar për parashkrimin e ndjekjes penale.”*

Ndërkaq sipas nenit 107 paragraf 5 të Kodit Penal NR.04/L-082 (i cili ka qenë në fuqi në kohën e aksidentit) theksohet se, citojmë: *“ Afati i parashkrimit ndërpritet me çdo veprim i cili ndërmerret për qëllime të ndjekjes penale të veprës penale të kryer”*. Ndërkaq sipas nenit 378 paragraf 4 të KPPK-s 04/L-082, për veprat penale në trafikun publik, kur vepra penale rezulton me lëndim të rëndë trupor, kjo vepër penale është e dënueshme prej një viti deri në tetë vite, ndërkaq sipas nenit 106 paragraf 1 pika 1.3 të Kodit Penal, theksohet se ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar 10 vite për veprën penale të dënueshme me më shumë se pesë vite burgim.

Andaj bazuar nga të lartcekurat nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk qëndrojnë si të bazuara pretendimet e të paditurës së dytë për parashkrim ngase siç shihet aksidenti në fjalë ka ndodhur me datë 04.09.2015, ku personi përgjegjës, drejtues i multikultivatorit është dënuar sipas aktgjykimit penal P.nr.355/2017 të datës 29.10.2021, i plotfuqishëm me datë 30.11.2021, çka do të thotë se në të dy rastet nuk ka arritur afati i parashkrimit, sepse në rastin konkret kemi të bëjmë me afatin prej 10 vitesh pasi që kërkesa e palës paditëse për kompensimin e dëmit ndërlidhet me veprimet e shkaktuara me vepër penale, ndërkaq pala paditëse si palë e zgjeron kërkesëpadinë në seancën e datës 18.01.2023, apo pas një viti e dy muaj nga plotfuqishmëria e aktgjykimit penal.

Në bazë të lartcekurave gjykata ka vërtetuar se të paditurat janë përgjegjëse ndaj paditësve konform përgjegjësisë në bazë të fajësisë, të paraparë me dispozitat ligjore sipas nenit 136, nenit 159 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) dhe dispozitave mbi kompensimin e dëmit konform shkallës së përgjegjësisë së tyre për dëmin material të shkaktuar, të parapara me dispozitat e nenit 169.2 të LMD-së, si dhe dëmit jo material konform nenit 183.1 të LMD-së, lidhur me nenin 323 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK).

Po ashtu gjykata e ka vlerësuar edhe pretendimin tjetër të të paditurës së dytë e cila ka theksuar se, paditësja në mënyrë të kundërligjshme është ulur në vendin jo adekuat në multikultivator, me ka të njëjtës duhet ti refuzohet kërkesëpadia, gjykata një pretendim të tillë nuk mund ta pranojë për faktin se i njëjti bie ndesh me aktgjykimin penal, pasi që drejtuesi i multikultivatorit pa mbulesë siguroese është dënuar me aktgjykimin penal, për shkak të rrezikimit të trafikut publik, sipas nenit 378 paragrafi 6 të ndërlidhur më paragrafin e 4 të KPPK-s 04/L-082, ku në këtë rast i njëjti është dënuar pikërisht për shkak të rrezikimit të jetës së paditësës.

Në lidhje me kërkesat e aprovuara në shumat si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata është e mendimit se të njëjtat janë adekuate, duke marrë parasysh dëmin që i është shkaktuar paditësës më rastin e aksidentit. Ndërsa lartësia e shumës së të hollave në emër të kompensimit, për palën paditëse do të jetë vetëm një satisfaksion që ai të jetë në gjendje që deri në një masë, t'i kompensojnë të mirat jo materiale nga të cilat është privuar, respektivisht atë shkallë të satisfaksionit të cilën ai do ta shfrytëzonte nëse të njëjtat nuk do t'i kishin humbur. Të gjitha këto duke pasur parasysh rrethanat e lëndimeve të shkaktuara, intensitetin e dhimbjeve dhe të frikës, kohëzgjatjen e tyre, kohën e nevojshme të shërimit dhe nevojat e shtuara të ushqimore. Po ashtu gjykata e refuzoi pjesën e kërkesëpadisë tek *dëmi jo material*, mbi shumat e vendosura si në pikën e një të dispozitivit, të kërkuar nga paditësja e cila ka të bëjë me kërkesën për dhimbje

shpirtërore dhe zvogëlim të aktivitetit jetësor, ku paditësja ka kërkuar shumën prej 12.700€, ndërsa gjykata ka vendosur që të aprovohet pjesërisht shumën prej 9000 euro.

Për llojet e frikës paditësja ka kërkuar shumën prej 3000 euro, ndërsa gjykata ka aprovuar pjesërisht shumën prej 2000 euro, kjo për faktin se paditësja nuk e ka përjetuar frikën primare, fakt i vërtetuar nga ana e mendimit të psikiatrit. Ndërsa lidhur me shëmtim paditësja ka kërkuar shumën prej 1500 euro, ndërsa gjykata ia ka aprovuar shumën prej 1000 euro.

Për zvogëlimin e aktivitetit jetësor prej 5%, paditësja ka kërkuar shumën prej 5000 euro, ndërsa gjykata ka aprovuar shumën prej 2000 euro, ku deri tek kjo shumë e vendosjes gjykata erdhi për faktin se gjykata vlerëson se kërkesa e paditëses është tejet e lartë në raport me zvogëlimin e aktivitetit jetësor.

Ndërkaq sa i përket çështjes së kërkesëpadisë së vendosjes për *dëmin material*, gjykata ka vendosur në saje të mendimit të ekspertit ortoped dr. Rr. Sh., i cili në mendimin e tij të datës 23.02.2017, ka theksuar se ndihma e personit tjetër ka qenë e nevojshme për 30 ditë, çka nënkupton se paditësja brenda këtij afati nuk ka mundur që të përkujdesej për nevojat e saja pa ndihmën e personit tjetër. Po ashtu i njëjti ekspert ka theksuar se paditësja pas aksidentit e ka pasur të domosdoshme që të përdorte ushqim të përforcuar, të përzgjedhur. Andaj për këto dy kategori të dëmit material gjykata vlerëson se shumën e vendosura nga ana e gjykatës janë ekuivalente më shpenzimet, përkatësisht përkujdesjen e personave të tretë ndaj paditëses.

Ndërkaq për pjesën e kërkesëpadisë të refuzuar për këtë kategori të dëmit gjykata e bëri në mungesë të provave, pagesave ku paditësja do duhej ti prezantonte para gjykatës lidhur me shpenzimet e mjekimit.

Lidhur me kamatën ligjore prej 8 % në vit, për të cilën gjykata vendosi si në pikën e parë të dispozitivit të këtij aktgjykimi, e cila për dëmin material fillon të rrjedh që nga dita parashtrimi të padisë datë 13.01.2016 e deri në përmbarimin definitiv, ndërsa për dëmin jo material nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit datë 13.06.2023, brenda afatit ligjor prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën nën përmbarim të dhunshëm, ku gjykata vendosi duke u bazuar konform nenit 382 të LMD.

Andaj, mbi bazën e të lartcekurave, gjykata vlerëson se shumën e kërkuara me kërkesëpadi përtej shumave të aprovuara, nuk janë reale dhe se të njëjtat nuk i përgjigjen shkallës së përgjegjësisë deliktore civile të të paditurave, ku deri tek shumën e vendosura gjykata ka marrë për bazë mendimet e eksperteve, pasojat pas aksidentit, gjendjen psikike të vlerësuar nga ekspertiza e psikiatrisë, moshën e re të paditëses e lindur me datë 07.10.1999, si dhe bazuar Udhëzuesi i Gjykatës Supreme të Kosovës 41/2023 i datës 27.02.2023, por gjithnjë duke u fokusuar në saje të provave të administruara dhe të arsyetuara si më lartë duke u ndërlidhur edhe me faktin se kompensimi i dëmit jo material është satisfakson për palën paditëse.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është nxjerr konform nenit 452 të LPK-së dhe tarifës zyrtare të OAK-s, obligohen të paditurat që në mënyrë solidare palës paditëse t'ia paguajnë shpenzimet si në vijim: për përpilimin e padisë 208 euro, për mbajtjen e seancave gjithsej 12 nga 208 euro, në shumën prej 2,496.00 euro, taksën në shumën prej 25 euro, ekspertiza e mjekëve dr. Rrahman Shala, ortoped dhe dr. Naim fanaj psikiater në shumën prej 300.00 euro, si dhe

shpenzimet e kërkuar nga ekspertët prof. Dr. N. L. dhe Mr.sc H. P. në vlerë prej 140 euro, në shumën totale prej 3,169.00 euro.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, sipas nenit 143 të LPK-së

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2020:917237, 13.06.2023**

G j y q t a r i

Selajdin Gallapeni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj Gjykate.